



Republika e Kosovës Republika
Kosova-Republic of Kosovo

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY FOR GENDER EQUALITY



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Gender Studies Center

HIRRJE PËR APLIKIM

Qendra Kosovare për Studime Gjinore hapë thirrjen për aplikim ndihmë financiare për nënat vetëushqyese, me qëllim të fuqizimit ekonomik të tyre. Kjo thirrje hapet në kuadër të projektit Agjencia për Barazi Gjinore në Kosovë (ABGj -Zyra e Kryeministrit, në kuadër të mbështetjes financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri dhe ekonomi – “Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021 -Masa 4 e fazës së dytë”.

Ky projekt i cili targeton grupet e ndjeshme ndër gratë, synon që t’i mbështesë nënat vetëushqyese, duke iu ofruar mbështetje financiare për zhvillim të kapaciteteve, fillimin e bizneseve të vogla (start ups) apo dhe shërbime tjera të cilat e përmirësojnë statusin ekonomik të nënave vetëushqyese.

Shuma maksimale për mbështetje është: 450 euro për çdo përfituese.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- **Formulari i plotësuar:** Formularin mund ta shkarkoni [këtu](#)
- **Dokument identifikimi** (Letërnjoftim ose pasaportë valide)
- **Dëshmia e statusit martesor** (kopje që tregon se aplikuesja është në proces të divorcit nëse është e aplikueshme)
- **Çertifikata e bashkësisë familjare**
- **Deklarata nën betim e nënshkruar:** Formularin mund ta shkarkoni [këtu](#)

Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dërgohen në email adresën info@kgscenter.net më së largu deri më datë 08/07/2021 deri në orën 17:00.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.